



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.532/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në kontestin tregtar administrativ të paditësit “G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati K.B nga Prishtina, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 7,297.48€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 27.10.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokat Kushtrim Bytyqi dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.S, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat K.B nga Prishtina,
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/311/2017 i datës 02.12.2020 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 7,297.48€ (shtatë/mijë/e/dyqind/e/nëntëdhjetë/e/shtatë/euro/e/katërdhjetë/e/tetë/cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-16213/14.04.2017 dhe R-19021/28.04.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ankesës e ushtruar tek e paditura 12.05.2017 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 18.01.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/311/2017 të datës 02.12.2020, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, shkeljes së dispozitave ligjore të udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e KDA-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së parimeve dhe rregullave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se : mbetet në tërësi si në të theksuarit në padi, duke konsideruar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenit 33 të KDA-së, lidhur me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ NR.11/2009, pasi që paditësi me rastin e paraqitjes së DUD-ave kontestues dhe në fazën e ankesës tek e paditura i ka bashkangjitur lëndës dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit sikurse janë faturat e mallit, urdhërpagesat bankare në emër të tyre si dhe kontratat për shitblerjen e mallrave, të gjitha këto të ndërlidhura në mes vete dhe të harmonizuara në kuptim të vlerës. Me anë të këtyre dokumenteve konsiderojmë se vërtetohet çmimi i paguar nga paditësi për mallrat e importuara, prandaj konsiderojmë se e paditura pa arsyetim të mjaftueshëm e ka kaluar metodën e parë të vlerësimit të mallrave, duke dhënë një arsyetim që nuk ka mbështetje ligjore lidhur me mungesën e deklaratave eksportuese, sepse ky dokument nuk është përcaktuar në mënyrë shprehimore si i obligueshëm për deklarimin e mallrave në procedurë doganore. E paditura konsiderojmë se e ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike me rastin e krahasimit të çmimit të mallrave lëndore me ato referente, pasi që kemi të bëjmë me mallra nga prodhues të ndryshëm, marka tregtare të ndryshme dhe të kualitetit të ndryshëm. Prandaj, është i kuptueshëm edhe ndryshimi i çmimeve në mes tyre. E paditura për shumicën nga mallrat lëndore ka pranuar çmimin e transaksionit, ndërsa për një pjesë të tyre e ka kontestuar, megjithëse bëhet fjalë për mallra të shoqëruara me dokumente të njëjta. Tutje, e paditura është referuar në disa DUD-a për mbështetjen e vendimit, e të cilët

po ashtu kanë disa emërtime të rivlerësuara me metodën gjashtë. Prandaj, të njëjtit nuk mund të merren për bazë edhe në këtë aspekt. E paditura nuk ka marrë për bazë vërejtjet dhe rekomandimet e gjykatës sipas aktgjykimit A.nr.1330/17 të datës 26.10.2020, dhe përsëri ka refuzuar kërkesën. Për shkak të rivlerësimit paditësi ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 4,559.58 €, për DUD R-16213/14.04.2017 dhe 2,737.90 € për DUD R-19021/28.04.2017, përkatësisht në total prej 7,297.48 €, të cilat kërkon ti kthehen së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8 %, nga data e ankesës e ushtruar tek e paditura 12.05.2017 në afat prej 15 ditësh, e deri në kthimin e plotë. Shumat për secilin DUD veç e veç janë nxjerrë duke u bazuar në DUD-at kontestues me MV1 pra ashtu siç janë deklaruar, dhe MV6 pas rivlerësimit, këto gjenden edhe në shkresat e lëndës. Duke marrë për bazë të theksuarat dhe provat e administruara i propozojë gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, ashtu që të anulojë aktvendimin e atakuar, dhe të detyrojë të paditurën që në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 4,559.58 €, për DUD R-16213/14.04.2017 dhe 2,737.90 € për DUD R-19021/28.04.2017, përkatësisht në total prej 7,297.48 €, t'ia kthehej paditësit së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8 %, nga data e ankesës e ushtruar tek e paditura 12.05.2017 në afat prej 15 ditësh, e deri në kthimin e plotë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 27.10.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor i autorizuari i palës së paditur deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se aktvendimi i Doganës së Kosovës është sjellë në kundërshtim me dispozitat ligjore, respektivisht nenit 33 të KDA-së, pasi që i njëjti në plotëni është i bazuar në dispozitat e KDA-së nenit 35, dhe rivlerësimi i mallit ka ardhur si pasojë e deklarimit më të ulët të vlerës së mallit se sa vlera reale e tij bazuar në të dhënat që disponon Dogana e Kosovës. Po ashtu nuk qëndron pretendimi i paditësit se i njëjti ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm dhe të harmonizuar për të

dëshmuar vlerën e malit, pasi që edhe dokumentacioni i prezantuar si fatura dhe kontrata kanë të meta dhe mangësi për të dëshmuar vlerën e transaksionit meqenëse në asnjërën prej këtyre dokumenteve nuk është e pashkruar llogaria e përfituesit apo eksportuesit-shitësit të mallit. Në këtë kuptim nuk mund të merret për bazë pretendimi i paditësit se ekziston lidhmëni në mes të këtyre dokumenteve, dhe rrjedhimisht paditësi nuk ka arritur të dëshmojë se vlera e deklaruar paraqet vlerën reale të paguar apo të pagueshme siç e precizon neni 33 i KDA-së. Paditësi po ashtu nuk ka paraqitur deklaratën eksportuese e cila paraqet një dokument të rëndësishëm për të dëshmuar vlerën e transaksionit, pasi që në këtë dokument pasqyrohet vlera e mallit dhe të dhënat e tjera për mallin të regjistruara në autoritetet Doganore të shtetit eksportues, edhe pse ky dokument nuk kërkohet bazuar në dispozitat e nenit 123 të UA nr.11/2009, por Dogana e Kosovës bazuar në nenin 92 të këtij Udhëzimi që parasheh përjashtim nga neni 123 kur Dogana dyshon se vlera e mallit nuk paraqet vlerën reale të transaksionit e që në rastin konkret bazuar në të dhënat që ka disponuar Dogana vlera e mallit të deklaruar ka qenë në vlerë dukshëm më të ulët. Përkundër kësaj edhe pse paditësi prej fazës ankimore në Doganë e deri në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor e ka ditur këtë fakt, nuk ka arritur që të prezantoj një dokument të tillë. Sa i përket pretendimit të paditësit në këtë seancë se vetëm disa pozicione të DUD-ave kontestues janë kontestuar, kurse emërtimeve të tjera u është pranuar vlera e transaksionit, paditësit i bëhet me dije që Dogana e Kosovës si parim pranon vlerën e transaksionit të mallrave të deklaruar kur bazuar në të dhënat e saj ajo vlerë parqet vlerën reale. Kurse në emërtimet që vlera e deklaruar paraqitet ose deklarohet dukshëm më e ulët se sa vlera e mallrave që importohen nga importues të tjerë prej të njëjtit vend të origjinës, dhe vlerës së mallrave të tilla në tregun e brendshëm është më e lartë, në këto raste importuesve u kërkohet të paraqesin dokumente shtesë për të dëshmuar vlerën e paguar për mallin. Sa i përket ndryshimeve, respektivisht diferencës së mjeteve të paguara ndërmjet asaj siç është deklaruar dhe pas rivlerësimit këto shuma janë të njëjta ashtu siç i theksojë edhe përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në këtë seancë dhe atë shuma prej 4,559.58 €, për DUD-in R-16213/14.04.2017 dhe 2,737.90 € për DUD-in R-19021/28.04.2017, përkatësisht në total prej 7,297.48 €. Nga të gjitha provat e prezantuara, ato të bashkangjitura lëndës në fazën paraprake e deri në këtë fazë, paditësi nuk ka arritur me asnjë provë të dëshmojë që vlera e mallit të deklaruar paraqet vlerën reale të mallit. Andaj, duke pasur parasysh që

Dogana ka ofruar dëshmi të mjaftueshme në lidhje me vlerën reale të mallit, propozojmë që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar, duke e lënë në fuqi aktvendimin e sjellë nga Dogana e Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 27.10.2022, ka administruar provat dhe atë: aktvendimet e Doganës së Kosovës nr.311 i dt.11.07.17, nr.311/2017 i datës 02.12.2020, DUD 16213 dt.14.04.17 me MV1 dhe MV6, fatura nr.YWJM 13450-04 e dt.11.01.17, kontrata me nr.YWJM 13450-04 e dt.11.01.17, DUD nr.19021 dt.28.04.17, me MV1 dhe MV6, fatura nr.YWJM 13450-05 i dt.17.01.17, kontrata me nr.YWJM 13450-05 e dt.17.01.17, përgjigja në padi e dt.27.10.2021, urdhër pagesa ndërkombëtare të Pro Credit Bankë e dt.31.05.17, urdhër pagesa ndërkombëtare e Pro Credit Bank e dt.22.06.17, urdhër pagesa ndërkombëtare e Pro Credit Bank e dt.20.06.17, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave dt.11.07.17 për DUD 16213, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave i dt.11.07.17 për DUD 19021, ankesa me nr.311 dt.12.05.17, DUD-at R-1040/26.01.2017, R-35634/05.08.2016, R-29125/02.07.2016, e-malil-et e datës 17.10.2020, 15.10.2020,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti “G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, këtu paditësi, përmes DUD-ve nr.R-16213/14.04.2017 dhe R-19021/28.04.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për

këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, në bazë të dhënave të disponueshme. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 11.07.2017, ka sjell aktvendimin nr. 01.3.2.2/311, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtij paditësit, tutje lidhur me këtë lëndë kjo Gjykatë duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin A.nr.1330/17 të datës 20.10.2020, ka aprovuar padinë e paditësit dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi në Rishqyrtim – rivendosje ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/311-2017 të datës 02.12.2020, me të cilin prapë ka refuzuar ankesën e këtij paditësit e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 18.01.2021 ka iniciuar prapë këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R-16213/14.04.2017 dhe R-19021/28.04.2017 të ZBD Prishtinë si të pabazuar. Tutje e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e malli e deklaruar për zhdoganim nuk është çmimi real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nëni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës pasi që këto të dhëna janë marr nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë.

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1330/17 të datës 26.10.2020, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në vendimin e parë refuzues me nr.01.3.2.2/441 të datës 11.07.2017, për rishqyrtimin e vendimeve nr. nr.R-16213/14.07.2017 dhe R-

19021/28.04.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë, ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështetur vendimin e kontestuar. Sipas të paditurës Dogana e Kosovës disponon me të dhëna nga Dosja e Vlerës dhe të dhënat e disponueshme që vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti.

Për Gjykatën një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me udhëzimet e dhëna nga Gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje. E paditura ka dështuar të veprojë sipas udhëzimit të dhënë me vendimin e Gjykatës me të cilin rasti ishte kthyer në rivendosje e ku e paditura ishte obliguar që në përputhje me autorizimet nga neni 82 paragrafi 1 të KDA-së, e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me faturat dhe transaksionet bankare të paditësit, për të konstatuar se faturat, transaksionet bankare dhe dokumentet përcjellëse pse nuk janë marr për bazë dhe nuk janë pranuar si valide.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave nr.R-16213/14.04.2017 dhe R-19021/28.04.2017 së Brendshme Doganore Prishtinë dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 7,297.48€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetur një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksionit bankar të datës 31.05.2017 dhe 22.06.2017 në Procredit Bank ne emër të faturës së mallit lëndor kontestues NO:YWJM13450-04 të datës 11.01.2017 dhe përmes transaksionit bankar të datës 20.06.2017 ne Procredit Bank në emër të pro faturës së mallit lëndor kontestues NO:YWJM13450-05 te datës 17.01.2017.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës, në bazë të të cilit vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat e mallit lëndor NO:YWMJM13450-04 të datës 11.01.2017 e cila është paguar përmes transfereve bankare të datës 31.05.2017 dhe 22.06.2017 në Procredit Bank, faturën NO:YWJM13450-05 të datës 17.01.2017 e cila është paguar përmes transferit bankar të datës 20.06.2017, kontratat e shitblerjes të datës 11.01.2017 dhe 17.01.2017. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 7,297.48€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të pa drejtë mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ave me nr. R-16213/14.04.2017 dhe R-19021/28.04.2017, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ankesës e ushtruar tek e paditura 12.05.2017 e deri në kthimin e plotë të kësaj shume.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e rivlerësimit të mallit nga e paditura nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe se kjo shumë u vërtetua edhe nga gjykata me rastin e krahasimit të vlerës së detyrimeve doganore në DUD-in e kontestuar, në versionin e paraqitur nga paditësi tek e paditura dhe atë të rivlerësuar, përkatësisht zbritja e vlerës $22,833.48€ - 18,273.91€ = 4,559.58€$ dhe $19,423.96€ - 16,686.06€ = 2,737.09€$, ku nga shuma e 4,559.58€ dhe 2,737.09€ rezultojë vlera 7,297.48€, e cila paraqet shumën e detyrimeve doganore të paguar nga paditësi si rezultat i ri vlerësimit të mallit nga e paditura.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”* dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077

për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkakimit të dëmit*” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.532/22, datë 27.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar Gashi

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.